

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga ENNA Power shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, me seli të regjistruar në adresën Gospodarska zona Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, përmes avokates Ana Kolevska nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 08.07.2026, solli këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi me të cilin ENNA Power shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, me seli të regjistruar në adresën Gospodarska zona Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, do të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Lumen Alpha d.o.o. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, me seli të regjistruar në adresën Dragutin Golik 89, Zagreb, Kroaci, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të ardhurave dhe programi 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 12.06.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ENNA Power shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, me seli të regjistruar në adresën Gospodarska zona Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, me të cilin ENNA POWER d.o.o. do të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Lumen Alpha d.o.o. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, me seli të regjistruar në adresën Dragutin Golik 89, Zagreb, Kroaci.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, vërtetoi si më poshtë:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

ENNA Power d.o.o. është shoqëri që merret me zhvillimin e projekteve për sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike në Kroaci dhe Evropë. Sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike mundësojnë ruajtjen e energjisë dhe shpërndarjen (dorëzimin) e saj fleksibël në përputhje me kërkesën.

ENNA Power d.o.o. është investitor udhëheqës dhe një nga grupet investuese me rritjen më të shpejtë në Kroaci, i cili është i përkushtuar në ofrimin e zgjidhjeve inovative që nxisin transformimin e gjelbër dhe krijojnë vlerë të qëndrueshme për partnerët dhe komunitetin, si në sektorin e energjisë ashtu edhe në atë të transportit, përkatësisht logjistikës.

ENNA Power d.o.o. është në pronësi 100% të ENERGIJA NATURALIS d.o.o. për investime dhe menaxhim, e cila është në pronësi të shoqërisë SUSTAINABLE SOLUTIONS HOLDING AG, pronar i së cilës është personi fizik Pavao Vujnovac.

Pavao Vujnovac është pronari përfundimtar edhe i grupit FORTENOVA, i cili është i pranishëm në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime MERCATOR MAKEDONIJA SHPKNJP Shkup - në likuidim, me NUAS 5938848 dhe seli në rr. Ognjan Prica nr. 1/3-28 mezaninë, Shkup – Kisella Vodë, me aktivitet prioritar të regjistruar: tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara kryesisht me ushqime, pije dhe duhan. Shoqëria e theksuar nuk është aktive komercialisht dhe është në procedurë likuidimi. Grupi ENNA dhe grupi FORTENOVA së bashku emërtohen si "Grupi PV". Grupi PV ka të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shitjes së produkteve ushqimore si vajra ushqimorë, margarinë, majonezë, ujëra minerale dhe lëngje, salca dhe shurupe, dhe produkte mishi (mish i thatë).

Lumen Alpha d.o.o. është shoqëri që është bartëse e dy projekteve për sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike (BESS), dhe atë: (1) BESS Buzet 1, me fuqi prej 9,99 MW dhe kapacitet prej 20 MWh dhe (2) BESS Buzet 2, me fuqi prej 9,99 MW dhe kapacitet prej 20 MWh. Lumen Alpha d.o.o. nuk ka prani në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ